

VENDIM
Nr. 979, datë 2.12.2020

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E
HARTIMIT TË PROJEKTIT TË NDËRHRYJEVE
REHABILITUESE/PËRSHTATËSE TË NEVOJSHME PËR KTHIMIN E
STRUKTURËS SË OBJEKTEVE, QË JANË KLASIFIKUAR SI OBJEKTE ME
DËMTIME TË MËDHA STRUKTURE OSE DËMTIME SHUMË TË RËNDA
JOSTRUKTURE, NË BASHKINË KAMZË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 19 323 960 (nëntëmbëdhjetë milionë e treqind e njëzet e tre mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekë, për financimin e hartimit të projektit të ndërhyrjeve rehabilituese/përshtatëse, për ndërhyrjet strukturale të nevojshme, për njësitë e banimit në ndërtesa (pallat), bazuar në rekomandimet e aktekspertizave të thelluara të bëra nga Instituti i Ndërtimit, në Bashkinë Kamzë.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, përballohet nga pjesa e financuar nga grantet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2020, dhe i transferohet Bashkisë Kamzë.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe